



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 823/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Laziq, dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhevdet Ademi, Kryesues i Qendrës së Votimit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si e pas afatshme ankesa e Xhevdet Ademi, Kryesues i Qendrës së Votimit në Viti

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.11.2013, nga Xhevdet Ademi, Kryesues i Qendrës së Votimit 2623D/02D fshati Lubishtë- Viti, në të cilën pretendohet se janë bërë pa rregullsi në këtë QV.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, konstatoi se ankesa e Xhevdet Ademi, është e pas afatshme sepse ankesa nuk është bërë në afatin e paraparë ligjor 24 orë nga shkelja e supozuar deri më 04.11.2013 ora 19:00, por e njëjta është dorëzuar më 12.11.2013 në ora 11:25.


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3.2 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pas afatshme

, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 823/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-

